

Plani strategjik i biznesit (PSB)

Titulli i KT:

KT 50 "Ndrëuesit dhe pajisjet e tjera që lidhen me to"

A Historiku

DPS/KT 50 është krijuar në 2004-02-28 në përputhje me Rregulloren e Brendshme të DPS-së duke ndjekur strategjinë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC mbi krijimin dhe funksionimin e komiteteve teknike. Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO si dhe hartimi i standardeve shqiptare në lidhje me dritën, ndriçimin dhe pajisjet që lidhen me to.

B Mjedisi i biznesit

B.1 Të përgjithshme

Standardet e KT 50 janë të fushës së shtyllave të ndriçimit deri në 20 m për aplikime për këmbësorë, rrugë dhe hapësira të hapura. Përveç ndriçuesve, në kolonat e ndriçimit mund të mbështeten objekte të vegjël si kamera, kuti lulesh, shenja të vogla, etj. Përfshihen flamujt dhe kabllot.

Kolonat e ndriçimit dhe xhantot përdoren gjerësisht në të gjitha zonat e urbanizuara dhe zonat që i nënshtrohen qarkullimit të automjeteve, kafshëve dhe këmbësorëve; këto përfshijnë rrugë, autostrada, vende parkimi, qytete, sheshe lojërash, etj.

Evropa përfaqëson tregun më të rëndësishëm të botës me traditë gati 100 ndvjeçare në kolonat e ndriçimit për rrugë, zona publike dhe private. Rëndësia e ndriçimit publik në gamën e sigurisë për zonat e trafikut dhe në peizazhin urban arkitektonik lidhet drejtpërdrejt me mënyrën evropiane të jetesës.

Sektorët e aplikimit janë: nga rruga e vogël deri te ndriçimi i autostradës, lagja e fshatrave të vegjël deri te qyteti i madh, zona publike dhe private, parqe dhe kopshte publike. Në përgjithësi çdo vend, drita mund të përmirësojë sigurinë, bukurinë, komoditetin dhe përdorshmërinë e peizazhit.

Palët e përfshira në aktivitetin KT 50 janë:

- industria prodhuese e strukturave të ndriçimit;
- operatorë të sektorëve të ndryshëm të aplikimit (furnizues, projektues);
- autoritetet publike, administratorët e rrugëve.

B.2 Treguesit sasiorë të mjedisit të biznesit

DPS/TK 50 trajton çështjet mjedisore:

- duke përdorur *checklist*-ën mjedisore të propozuar në Udhëzuesin CEN 4;
- duke marrë parasysh Pikën e 7-të të Aneksit I, Kërkesat themelore për punimet e ndërtimit të Rregullores (BE) Nr. 305/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 mars 2011 duke vendosur kushte të harmonizuara për tregtimin e produkteve të ndërtimit dhe

duke shfuqizuar Direktivën e Këshillit 89/106/EEC gjatë rishikimit të standardeve të produkteve:

“7. Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Punimet e ndërtimit duhet të projektohen, ndërtohen dhe prishen në mënyrë të tillë që përdorimi i burimeve natyrore të jetë i qëndrueshëm dhe në veçanti të sigurojë sa vijon:

- (a) ripërdorimi ose riciklimi i punimeve të ndërtimit, materialeve dhe pjesëve të tyre pas prishjes;
- (b) qëndrueshmëria e punimeve të ndërtimit;
- (c) përdorimi i lëndëve të para dhe dytësore të përputhshme me mjedisin në punimet e ndërtimit.”

C Përfitimet

Përcaktimi i një terminologjie dhe dimensionesh të përbashkëta është thelbësor për Tregun Evropian.

Për shkak të ekzistencës së rregulloreve të ndryshme kombëtare, produktet mbuloohen nga direktiva 89/106/CEE për produktet e ndërtimit, prandaj standardet e publikuara janë standarde të harmonizuara, duke lejuar qarkullimin e produkteve në Tregun Evropian.

Përcaktimi i kriterëve strukturore që do të miratohen për strukturat e ndriçimit, të bëra me materiale të ndryshme është i një rëndësie thelbësore për t'u dhënë autoriteteve publike specifikimet e përgjithshme për të blerë strukturë ndriçimi me gjendje kualifikimi standard.

Përcaktimi i rregullave bazë për konkurrentët ka për qëllim të garantojë respektimin e kushtet themelore të projektimit.

D Përparësitë

KT 50 është një nga komitetet më të vjetra ekzistuese. Aktualisht, 9 standarde janë të vlefshme, që mbulojnë aspekte të përgjithshme dhe produkte të prodhuara nga 4 materiale të ndryshme. Prioritetet janë:

- Rishikimi i fushës së standardeve ekzistuese për të bërë të qartë se:
 - produktet në fjalë janë shtylla ndriçimi deri në 20 m;
 - produktet phase mund të mbështesin bashkëngjitje të vogla si kamera, kuti lulesh, shenja të vogla etj.;
 - përjashtohen flamujt dhe kabllot.
- Rishikimi i standardeve ekzistuese dhe Aneksit ZA në mënyrë që të jetë në përputhje me Rregulloren e produkteve të ndërtimit (CPR).
- Përpunimi i një standardi të ri për të mbuluar instalimin dhe mirëmbajtjen.
- Rishikimi i standardeve ekzistuese për të përcaktuar procedurat eksperimentale për testet fillestare dhe në terren.
- Rishikimi i standardeve ekzistuese sipas përvojës së fituar, përta i përket materialit, formës dhe zgjidhjeve arkitekturore.
- Përdorimi i materialit të munguar si druri që përdoret gjerësisht në disa vende evropiane.

Përpunimi i një standardi të ri për të mbuluar instalimin dhe mirëmbajtjen.

D Pjesëmarrja në KT 50

Në KT 50 ka përfaqësues nga institucionet publike jofitimprurëse, institucione të arsimit të lartë dhe organizma qeveritare. Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje të veçanta.

E Objektivat dhe strategjitë

E.1 Objektivat e përcaktuara nga KT 50

Objektivat kryesore të KT 50 janë të mbajnë parasysh Rregulloren e re të Materialeve të Ndërtimit (CPR) për zbatim deri në 2013-07-01 dhe të përditësojnë standardet ekzistuese. Për arritjen e këtyre objektivave, standardet e deritanishme e adoptuara nga KT 50, do të rishikohen.

Për ta administruar siç duhet këtë rishikim, është rënë dakord për 5 detyrat e mëposhtme:

Detyra 1: Rishikimi i standardeve aktuale të harmonizuara në përputhje me CPR.

Detyra 2: Kombinimi i EN 40-1 dhe EN 40-2 aktual në një EN 40-1 të ri.

Detyra 3: Rishikimi i përmbajtjes teknike të EN 40-3, pjesët 1 deri në 3.

Detyra 4: Rishikimi i standardeve aktuale të materialit për t'i kombinuar ato në standardin e ri të harmonizuar EN 40-2 me një pjesë në kolonat e çelikut, aluminit, betonit dhe kompoziteve si dhe krijimi i një pjese të re që merret me kolonat e ndriçimit me bazë druri.

Detyra 5: Puna për një standard të ri që ka të bëjë me instalimin dhe mirëmbajtjen.

Janë miratuar datat e mëposhtme të objektivave:

Detyra 1: Dorëzimi i projekteve përkatëse të standardeve evropiane në Procedurën Unike të Pranimit (UAP) deri në qershor 2013.

Detyrat 2, 3 Qarkullimi i projektit të parë deri në qershor 2013, finalizimi deri në mars 2014.

Detyra 4: Dorëzimi i projekteve përkatëse të standardeve evropiane në votim formal deri në dhjetor 2014.

Detyra 5: Finalizimi i projektstandardeve evropiane shoqëruese deri në fund të vitit 2015.

Janë vendosur rregullat e punës.

E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përparësitë aktuale kanë të bëjnë me:

- rishikimin e standardeve ekzistuese, duke i përditësuar ato dhe duke marrë parasysh praktikat dhe njohuritë e reja më të mira, të marra që nga koha e hartimit të standardeve;
- punë para normative në pika të veçanta (p.sh. rezistenca e hapjes, dridhjet, koeficientët e forcës, etj.).

Përmbushja e objektivave të KT 50 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane, ndërkombëtare dhe dokumente standardizimi si standarde shqiptare SSH dhe DS, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 50	Shtylla ndriçimi dhe bokulla
CEN/TC 169	Dritë dhe ndriçim
ISO/TC 274	Pajisjet mbështetëse të avionëve në tokë
CIE	Komisioni Ndërkombëtar për Ndriçimin

F Planifikimi

Për realizimin e objektivave të mësipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve dhe të dokumenteve të standardizimit.

G Financimi

Kryetari dhe anëtarët e KT punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagese
Sekretari i KT është punonjës i DPS

Sekretari i KT 50

(Arben DERVISHI)